

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5685
E premte, 25 janar 2019
çmimi 0.40 €

Majlinda, e 'artë' në Izrael I FAQE 14



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

REVOLUCIONI ASIMETRIK I KOHËS SONË F. 11

Prof. Lisen
BASHKURTI



MUSTAFA: TAKSA U VENDOS PËR T'I MBULUAR DËSHTIMET E QEVERISË F. 7

UJËSJELLËSI DO T'I SHKYÇË BORXHLINJTË NGA SISTEMI F. 8

EKONOMI



KDI-ja, KUVENDIT: TË RESPEKTOHEN PROCEDURAT LIGJORE PËR TRAJTIMIN E PROJEKTLIGJIT PËR BUXHETIN F. 9

EDHE KOSTT-I ME VALA F. 8

KULTURË

SHFAQET PREMIERA E FILMIT DOKUMENTAR 'KOHA E PELIKULËS' F. 13



SPORT

DY DERBI NË BASKETBALL F. 14



FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHAR SELIMI I FAQE 4-5

Sigurimi shëndetësor për policinë të jetë prioritet këtë vit

Ish-komandanti i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka ftuar institucionet e vendit që këtë vit ta kenë prioritet sigurimin shëndetësor për Policinë e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se kjo do të ndikonte në performancën e policisë. Sipas tij, sigurimi shëndetësor do ta inkurajonte më shumë përkushtimin policor për shërbim ndaj të tjerëve. "E kuptoj problemin financiar, por duhen veçuar policët, ushtarët, zjarrfikësit dhe gardianët nga profesionet e tjera", ka thënë ai. Selimi ka folur edhe për shtimin e grabitjeve kohët e fundit në Kosovë, duke bërë me dije se për luftimin e këtyre dukurive duhet këmbëngulur për zbatimin e strategjisë së policisë në bashkësi.

Në muajin maj mbahet mbledhja e përbashkët e dy qeverive Kosovë - Maqedoni

Mbledhja e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë Veriore do të mbahet në muajin maj. Këtë e ka bërë me dije të enjten zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, pas takimit që ka pasur me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë Veriore, Bujar Osmani. Në këtë takim Hoxhaj e Osmani kanë diskutuar për progresin në marrëdhëniet mes dy vendeve I FAQE 3



Durim Limaj në Sarajevë: E heqim taksën nëse na njih Bosnja I FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vite, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Hahn takon Thaçin e Vuçiqin, flasin për taksën dhe dialogun

PRISHTINË, 24 JANAR - Komisionari i Bashkimit Evropian për Zgjerim, Johannes Hahn, i cili po merr pjesë në Forumin Botëror të Ekonomisë në Davos të Zvicrës, ka takuar presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi dhe atë të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Në këtë takim është diskutuar për dialogun dhe për taksën që ka vendosur Kosova ndaj mallrave të Serbisë dhe të Bosnjë e Hercegovinës. Sipas komisionarit Hahn, si Thaçi ashtu edhe Vuçiqi e dinë se zgjidhja është e nevojshme. "Kam parashtruar



një propozim në të cilin do t'i trajtojmë të gjitha çështjet relevante tregtare në lidhje me Serbinë dhe Kosovën. Jam gati të

drejtoj një intervistë të tillë", është shprehur Hahn, duke shtuar se pret reagimin pozitiv të presidentit serb Vuçiq dhe atij të

Kosovës, Thaçi. Sipas tij, kjo do të nënkuptojë edhe vazhdimin e dialogut.

Në një intervistë për "N1.hr", Hahn ka thënë se gjatë takimit me Thaçin dhe Vuçiqin, që të dy e dinë se zgjidhja është shumë e nevojshme. "Të dy e kuptojnë propozimin tim, edhe një herë i kam diskutuar në detaje me propozimin dhe në ditët e ardhshme pres përgjigjen e tyre pozitive. Ata e kuptojnë se Kosova dhe Serbia duhet patjetër të ulen për ta thirrur këtë tregti. Ata i quajnë irritime,

thjesht të shoqëruara, se ky është kusht themelor për vazhdimin e bisedimeve konkrete dhe dialogun konkret", tha Hahn. Sipas komisionarit Hahn, nëse gjendet një zgjidhje dhe të vazhdohet dialogu atëherë, siç u shpreh ai, dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë mund të vazhdojë deri në fund të vitit.

"Për ta shkurtuar historinë, jam i bindur se mund ta trajtojmë këtë problem dhe supozoj se dialogu midis Serbisë dhe Kosovës mund të vazhdojë deri në fund të vitit", deklaroi Hahn.

NATO nis projektin e bazës ajrore të Kuçovës

Investimi i NATO-s për modernizimin e bazës ajrore në Kuçovë parashikohet të kushtojë rreth 51 milionë euro, që e kthen atë në një bazë mbështetëse për furnizim ajror, logjistikë, stërvitje dhe policim ajror, duke rritur sigurinë e rajonit

TI RANË, 24 JANAR - Aleanca Veri-Atlantike nisi të enjten në Shqipëri zbatimin e paketës investuese në bazën ajrore të Kuçovës gjatë pesë vjetëve të ardhshëm.

Komandanti i Forcave Ajrore të NATO-s, gjeneral Tod D. Wolters, iu bashkua të enjten ceremonive për çeljen e këtij projekti pranë Ministrit të Mbrojtjes në Tiranë, ndërsa avionë F16 dhe Eurofighters fluturuan mbi qiellin e kryeqytetit. "Është e vështirë të besohet se vetëm 10 vjet më parë, në pranverën e 2009-s, Shqipëria u bë anëtare e NATO-s dhe brenda një kohe të shkurtër po nisim përmirësimin e infrastrukturës së bazës ajrore të Kuçovës. Brenda pak muajsh dhe vitesh ajo do të shndërrohet si parajsja e avionëve në Kuçovë. Jemi shumë të gëzuar që po përparojmë në këtë drejtim. Forcat e Armatosura të Shqipërisë po japin ndihmesën e tyre për ruajtjen e paqes në rajone të ndryshme. Paqja që ju shpërndani në një territor të gjerë është e mrekullueshme për Aleancën, ku të gjithë së bashku mbështetnin zhvillimin dhe sigurinë e këtij rajoni", tha gjenerali Wolters. Vizita e komandantit të forcave ajrore të NATO-s për ta shënuar nisjen e fazës së parë të punimeve në bazën ajrore të



Kuçovës përkoji me 70-vjetorin e krijimit të Aleancës Veri-Atlantike dhe 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në të. "Shqipëria është një vend i sigurt, ku Aleanca do t'i investojë kapacitetet e saj, gjë që rrit sigurinë kombëtare dhe sigurinë në të gjithë Ballkanin", tha ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

Ushtarakët vlerësojnë se baza e Kuçovës ka një infrastrukturë ekzistuese të jashtëzakonshme, një vendndodhje gjeografike të veçantë dhe klimë të favorshme për shikueshmërinë e manovrave. Masterplani po përgatitet nga Agjencia e NATO-s për prokurimet dhe mbështetjen NSPA. Investimi i NATO-s për modernizimin e bazës ajrore në Kuçovë parashikohet në rreth 51 milionë euro, që e kthen atë në një bazë mbështetëse për furnizim ajror, logjistikë, stërvitje dhe policim ajror, duke rritur sigurinë e rajonit.

Ekipi negociator javën e ardhshme takohet me Mogherinin

PRISHTINË, 24 JANAR - Ekipi negociator i drejtuar nga Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti javën e ardhshme do të takohet në Bruksel me përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, në kuadër të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këtë takim e ka konfirmuar të enjten zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj, i cili ka thënë se platforma për dialogun do të jetë gati të hënën për ta dërguar në Bruksel, por ne do ta tregojmë vullnetin tonë për ta vazhduar dialogun dhe të martën do të jemi në Bruksel. Javën e ardhshme do ta prezantojmë platformën në Kuvend dhe kjo është mënyra më e mirë se si t'i qasemi dialogut", ka deklaruar Hoxhaj pas takimit me homologun e vet maqedonas Bujar Osmani. Sipas Hoxhajit, taksa ndaj Serbisë është

mënyra më e mirë që të tregohet se Kosova është shtet sovran. "Taksa ka qenë mënyra më interesante për t'iu treguar se Kosova është shtet dhe askush nuk mund ta ndalë rrjedhën e historisë", është shprehur Hoxhaj, duke shtuar se ndaj Serbisë mund të ketë edhe masa të tjera. "Nëse Serbia nuk ndalet, kemi edhe ide të tjera kreative", ka deklaruar ai.

Hoxhaj ka theksuar se përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, duhet të ushtrojë presion mbi Beogradin në mënyrë që ta ndalojë kampanjën e Serbisë për tërheqjen e njohjeve të Kosovës. "Interesat tona si shtet dhe të Amerikës janë të njëjta. Jemi në rrugë të mbarë që Serbia ta ndalë këtë agresion diplomatik dhe Mogherini e të tjerët duhet ta ushtrojnë ndikimin mbi Beogradin për ta ndaluar kampanjën për tërheqjen e njohjeve të Kosovës", ka deklaruar Hoxhaj.



Presidenti Meta kushtëzon Gent Cakajn

TI RANË, 24 JANAR - Me rastin e 100-vjetorit të ndarjes nga jeta të Ismail Qemalit, figurën e themeluesit të shtetit modern shqiptar e ka nderuar edhe presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta.

Pasi ka vendosur lule pranë shtatores së Qemalit, Meta ka përmendur Kushtetutën kur është pyetur për rezervat e shfaqura nga mazhoranca ndaj Bahri Shaqirit, këshilltarit të tij për siguri që Meta e ka propozuar për ta drejtuar Kontrollin e Lartë të Shtetit

(KLSH).

"Kushtetuta, interesi kombëtar dhe interesi publik janë të vetmet që më udhëheqin në veprimet e mia dhe në aktet e mia", ka thënë Meta.

Më tutje, Meta nuk i ka hequr asnjë "presje" reagimit të një dite më parë për kompetencat që kryeministri Edi Rama ia ka deleguar zëvendësministrit Gent Cakaj, për të drejtuar në vend të tij Ministrinë e Jashtme. "Unë e kam shumë të qartë si president i Republikës, edhe për

shkak të vendimit vizionar të Gjykatës Kushtetuese, se kujt institucioni mund t'i delegoj autoritetin kushtetues për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë", ka thënë Meta.

Një rast konkret kur presidentit i kërkohet të japë plotfuqinë për marrëveshje ndërkombëtare është ai për paktin detar me Greqinë. Ndonëse jo menjëherë, presidenti Meta ia dha autorizimin Ditmir Bushatit vitin e kaluar për sa i përket



grupit negociator.

Por, firma e kreut të shtetit nevojitet edhe një herë të dytë para se marrëveshja të kalojë në Parlament, rast në të cilin Meta

mund të hezitojë për shkak të rezervave të shprehura publikisht ndaj zëvendësministrit Gent Cakaj, i cili drejton "de facto" diplomacinë shqiptare.

Zëvendëskryeministri i Maqedonisë Veriore, Bujar Osmani, ka vizituar Kosovën, me ç'rast është pritur në takim nga zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj

Në maj mbahet mbledhja e përbashkët e dy qeverive Kosovë - Maqedoni

Mbledhja e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë Veriore do të mbahet në muajin maj. Mbatjen e kësaj mbledhje në këtë kohë e ka bërë me dije të enjten zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, pas takimit që ka pasur me zëvendëskryeministrin e Maqedonisë Veriore, Bujar Osmani. Në këtë takim Hoxhaj e Osmani kanë diskutuar për progresin në marrëdhëniet bilaterale mes dy vendeve



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 JANAR - Zëvendëskryeministri i Maqedonisë Veriore, Bujar Osmani, të enjten ka vizituar Kosovën, me ç'rast është pritur në takime të ndara nga zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj dhe ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha. Me këtë rast zëvendëskryeministri Hoxhaj ka bërë me dije se mbledhja e përbashkët në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë Veriore do të mbahet në muajin maj, në të cilën pritet të nënshkruhen disa marrëveshje nga fusha të ndryshme.

Zëvendëskryeministrat Hoxhaj e Osmani kanë diskutuar për një sërë temash të bashkëpunimit bilateral në mes të Kosovës dhe Maqedonisë Veriore. Me këtë rast, zëvendëskryeministri Hoxhaj ka

uruar zëvendëskryeministrin Osmani për votimin në Kuvend të Marrëveshjes së Prespës për zgjidhjen e çështjes së emrit si dhe për Ligjin për Përdorimin e Gjuhës Shqipe. Sipas Hoxhajt, kjo është e arritur e madhe për Maqedoninë Veriore, për rrugën e saj euroatlantike, por edhe për shqiptarët dhe rolin e tyre konstruktiv që kanë treguar gjatë proceseve më të rëndësishme për vendin. "Kënaqësi ta pres në Prishtinë homologun tim nga Shkupi, zëvendëskryeministrin Bujar Osmani. Diskutuaam për një varg bashkëpunimesh mes dy vendeve tona si dhe për mbajtjen e mbledhjes së parë të përbashkët të dy qeverive në maj të këtij viti. E urova për votën për Marrëveshjen e Prespës në parlament si dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhës Shqipe. Të dyja këto, arritje të mëdha për shtetin maqedonas dhe shqiptarët e atjeshëm", ka deklaruar

zëvendëskryeministri Hoxhaj. Ndërsa zëvendëskryeministri i Maqedonisë Veriore, Bujar Osmani, ka folur për rëndësinë e progresit në marrëdhëniet bilaterale në mes të dy vendeve, për perspektivat euroatlantike për rajonin, si dhe për projektet e interesit të përbashkët.

Me këtë rast ai ka përmendur ndërtimin e aneksit të autostradës nga Shkupi deri në Bllacë, e cila do ta zvogëlojë ndjeshëm kohën e lëvizjes nga njëri shtet në tjetrin.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, zëvendëskryeministri Osmani është pritur në takim edhe nga

ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, së cilës i ka shprehur gatishmëri për ofrimin e përvajave në procesin integruar të Maqedonisë Veriore, duke theksuar se gjenden disa hapa përpara në proces. Ai ka thënë se përkushtimi i shtuar në këtë proces dhe këmbimi i përvajave do të ishte i mirëseardhur për të dyja vendet.

Kurse ministrja Hoxha e ka përgëzuar zëvendëskryeministrin Osmani për të arriturat e Maqedonisë Veriore në muajt e fundit, duke shprehur gatishmërinë e thellimit të bashkëpunimit. "Bashkëpunimi

ynë duhet të njohë dinamizim dhe përkushtim të shtuar për çështjet me interes të dy vendeve tona dhe rajonit. Ne duhet të kemi përparime të tjera edhe për proceset dhe rrugën e përbashkët integruar", ka deklaruar ministrja Hoxha.

Zëvendëskryeministri Osmani ka takuar edhe shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalia Apostolova, me të cilën ka biseduar për përparimin dhe sfidat gjatë zbatimit të projekteve për bashkëpunim ndërkufitar, në veçanti për projektin Belanoc - Stançiq që është në fazën përfundimtare të realizimit.

Durim Limaj në Sarajevë: E heqim taksën nëse na njeh Bosnja

PRISHTINË, 24 MAJ - Bosnja dhe Kosova kanë paraqitur qëndrimet e tyre në lidhje me tarifën ndaj mallrave të Bosnjës të vendosur nga Qeveria e Kosovës gjatë një takimi që delegacionet e të dyja vendeve kanë pasur të enjten në Sarajevë. "Të dyja palët kanë paraqitur qëndrimet e tyre. Pozicionet para këtij takimi kanë qenë shumë të kundërta" ka thënë pas takimit zëvendëskryeministri për Tregti të Jashtë dhe Marrëdhëniet Ekonomike të Bosnjës, Midhat Saliq. Ai ka thënë se pala e Kosovës ka kërkuar nga Bosnja t'i njohë dokumentet e Kosovës, pasaportat dhe tabelat e veturave si dhe ta heqë regjimin e vizave. "Ne në plan të parë kemi potencuar pyetjet ekonomike. Gjithashtu, thamë se në këtë mënyrë shkelet marrëveshja e CEFTA-s për tregti të lirë. Ajo që pala e Kosovës ka potencuar gjatë bisedimeve ishte se Bosnje dhe Hercegovina po pamundëson

lëvizjen e kapitalit, njerëzve dhe shërbimeve për shkak të regjimit të vizave dhe mospranimit të dokumenteve të Kosovës", ka thënë zëvendëskryeministri Saliq. Kërkesë e delegacionit të Bosnjës ishte që menjëherë dhe pa kushte të shfuqizohet tarifa ndaj mallrave të saj nga ana e autoriteteve në Prishtinë, përderisa delegacioni kosovar ka kërkuar që para se të shfuqizohet tarifa, Bosnja ta njohë pavarësinë e Kosovës, dokumentet e saj dhe t'i heqë vizat. "Ne kemi ofruar maksimumin nga ana jonë. Kërkuam që Kosova ta tërheqë tarifën në afat prej gjashtë muajsh dhe gjatë kësaj periudhe të zgjidhen çështjet e paraqitura. Megjithatë, pala e Kosovës këtë nuk e pranoi", ka thënë anëtari i delegacionit të Bosnjës, Midhat Saliq.

Pjesë e takimit ishte edhe shefi i kabinetit të ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Durim Limaj. Ai



në një intervistë për televizionin "Al Jazeera në Sarajevë", ka thënë se hapi më i afërt për heqjen e taksës ndaj mallrave boshnjake është njohja e Kosovës nga Bosnja dhe Hercegovina. "Ne iu kemi përgjigjur ftesës së dytë të Bosnjës për takim në kuadër të marrëveshjes së CEFTA-s, edhe

pse ftesa nuk na është bërë si Kosovë, por ftesa ishte si pjesë e CEFTA-s. Ky takim shënon të parin bashkëpunim ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Bosnjës dhe Hercegovinës", ka thënë Limaj. Ai ka shtuar se janë nevojitur dhjetë vjet që nga pavarësia e

Kosovës që të organizohet një takim i tillë. "Sot i kemi njoftuar institucionet e Bosnjës për masat që ka ndërmarrë Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne u kemi thënë kolegëve tanë nga Bosnja se jemi të gatshëm ta heqim taksën nëse pranohen kërkesat tona", ka thënë Limaj.

Flet për "Epokën e re", Behar Selimi

Sigurimi shëndetësor për poli



Ish-komandanti i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka ftuar institucionet e vendit që këtë vit ta kenë prioritet sigurimin shëndetësor për Policinë e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se kjo do të ndikonte në performancën e policisë. Sipas tij, sigurimi shëndetësor do ta inkurajonte më shumë përkushtimin policor për shërbim ndaj të tjerëve. "E kuptoj problemin financiar, por duhen veçuar policët, ushtarët, zjarrfikësit dhe gardianët nga profesionet e tjera", ka thënë ai. Selimi ka folur edhe për shtimin e grabitjeve kohët e fundit në Kosovë, duke bërë me dije se për luftimin e këtyre dukurive duhet këmbëngulur për zbatimin e strategjisë së policisë në bashkësi

bilanceve financiare private e publike, vigjilenca e relaksuar qytetare para dhe pas ndërrimit të motmoteve, e faktorë të ngjashëm socialë, si kudo në botë, edhe tek ne ndikojnë që këto dhe krime të ngjashme të shtohen. Ndryshe, këto hyjnë në kuadër të krimeve sezonale, të cilat, sipas statistikave kriminalistike, shfaqen të shtuara në vjeshtë dhe dimër", është shprehur ai.

Njohësi i çështjeve të sigurisë ka treguar edhe se çfarë duhet të bëjnë institucionet e vendit për t'i ndaluar këto raste. Selimi ka thënë se duhet këmbëngulur për zbatimin e strategjisë së policisë në bashkësi bashkë me strategjinë e policisë nëpërmjet inteligjencës. "Me vigjilencë të shtuar, bashkëpunim me agjencitë private të sigurisë dhe duke këmbëngulur për zbatimin e strategjisë së policisë në bashkësi, bashkë me strategjinë e

policisë nëpërmjet inteligjencës. Besoj fuqishëm se lidhshipi aktual i policisë është duke vazhduar, mbase edhe më mirë se paraardhësit, duke më përfshirë edhe mua, që suksesin e parandalimit të krimeve ta arrijë nëpërmjet zbatimit fanatik të këtyre strategjive", ka thënë Selimi.

"Epoka e re": Z. Selimi, së fundmi kemi pasur numër të madh të vjedhjeve dhe grabitjeve në vend. Si njohës i çështjeve të sigurisë, pse mendoni se janë shtuar këto raste?

Selimi: Mbase rrethanat që krijohen në festat e fundvitit, mbyllja e bilanceve financiare private dhe publike, vigjilenca e relaksuar qytetare para dhe pas ndërrimit të motmoteve, e faktorë të ngjashëm socialë, si kudo në botë, edhe te ne ndikojnë që këto dhe krime të ngjashme të shtohen. Ndryshe, këto hyjnë në kuadër të krimeve sezonale, të

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 JANAR - Ish-komandanti i Policisë së Kosovës, Behar Selimi, ka bërë me dije se sigurimi shëndetësor do ta inkurajonte më shumë përkushtimin policor për shërbim ndaj të tjerëve. Ai i ka ftuar institucionet e Kosovës që këtë vit ta kenë prioritet sigurimin shëndetësor për Policinë e Kosovës. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka thënë se e kupton problemin financiar, por në këtë drejtim duhen veçuar policët, ushtarët, zjarrfikësit dhe gardianët. "Debati për sigurim shëndetësor është debat gati dy dekadash. Uroj dhe apeloj që kjo çështje sa më parë të kryhet. E kuptoj problemin financiar, por duhen veçuar policët, ushtarët, zjarrfikësit dhe gardianët nga profesionet e tjera, pastaj kjo

çështje rregullohet më lehtë. Është krejtësisht e kuptueshme pastaj se sigurimi shëndetësor do ta inkurajonte më shumë përkushtimin policor për shërbim ndaj të tjerëve. Pra, sa më parë", ka thënë Selimi. Ai ka folur edhe për shtimin e rasteve të vjedhjeve në vendin tonë. Sipas Selimit, këto krime shtohen kudo në botë për fundvit. "Mbase rrethanat që krijohen në festat e fundvitit, mbyllja e

cinë të jetë prioritet këtë vit



dekadash. Uroj dhe apeloj që kjo çështje sa më parë të kryhet. E kuptoj problemin financiar, por duhen veçuar policët, ushtarët, zjarrfikësit dhe gardianët nga profesionet e tjera, pastaj kjo çështje rregullohet më lehtë. Është krejtësisht e kuptueshme pastaj se siguri shëndetësor do ta inkurajonte më shumë përkushtimin policor për shërbim ndaj të

tjerëve. Pra, sa më parë.

"Epoka e re": *Ministria e Punëve të Brendshme që një muaj ka marrë një vendim për legalizimin e armëve ilegale. Si e keni parë këtë veprim dhe sa do të ndikonte në sigurinë publike?*

Selimi: Po, ministria ka marrë vendim për zbatimin e Ligjit për legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve

eksplozive. Pra, përfaqësuesit e popullit kanë vendosur të bëhet kështu, të bindur se kjo është politikë e drejtë. Edhe unë besoj se po, meqë kjo politikë synon edhe dorëzimin pa ndëshkim dhe futjen nën kontroll të një numri të madh armësh dhe eksploziveve, aktualisht jashtë administrimit shtetëror. Pra, legalizimi synon kontrollin dhe kjo duhet të bëhet.

Nxënësit në shtëpi, mësimdhënësit në grevë

PRISHTINË, 24 JANAR - Më shumë se 350 mijë nxënës të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe rreth 110 mijë studentë në Kosovë për afër dy javë nuk janë duke vijuar procesin mësimor si rrjedhojë e grevës së mësimdhënësve. Mësimdhënësit vazhdojnë të jenë këmbëngulës për realizimin e kërkesës së tyre që ka të bëjë me rritjen e koeficientit të pagës.

Në bazë të Projektligjit aktual për pagat, në koeficientet nga 1.7 deri në 2.5, përfshihen përfaqësues të sistemit të arsimit, bashkë me edukatorët e kopshteve deri te drejtorët e shkollave të mesme. Kërkesa e Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë dhe e Këshillit është ngritja e koeficientit për punonjësit e arsimit së paku 30 për qind. Por, mosvijimi i procesit mësimor nga ekspertët e çështjeve të arsimit dhe përfaqësuesit e prindërve konsiderohet se do të sjellë pasoja të mëdha për nxënësit dhe gjithë procesin e arsimit në të ardhmen e afërt. Ministri i Arsimit, i Shkencës

dhe i Teknologjisë në Qeverinë e Kosovës, Shyqiri Bytyqi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se dëmi më i madh nga kjo grevë është duke iu bërë pikërisht nxënësve. Bytyqi thotë se të gjitha orët e humbura do të mund të kompensohen por që, gjithsesi, sipas tij, nuk do të kenë efektet e duhura. "Brenja jonë që nga fillimi ka qenë që mos të humbet asnjë ditë mësimi pasi do të jetë një dëm i madh për nxënësit tanë. Kjo ishte edhe arsyeja që nuk u pajtuam me SBASHK-un që të fillojë greva. Me SBASHK-un ishim që të gjejmë alternativa dhe ishim në përkrahje të tyre që renditja e mësimdhënësve në renditjet e koeficientit në Projektligjit për paga të ketë një vend meritore", ka thënë ai, duke shtuar se të gjitha zgjidhjet e tjera mund të bëhen dhe duhet të bëhen në një kohë të caktuar, por dëmi që u bëhet nxënësve është i parikopërueshëm. "Pavarësisht se ne mund t'i kompensojmë këto orë, mund të marrim një vendim që të gjitha orët e humbura të kompensohen, por nuk

e ka efektin sikur tani të ishin mbajtur orët e rregullta të mësimi", ka thënë Bytyqi. Ministri Bytyqi thotë se Qeveria ka reflektuar karshi kërkesave të SBASHK-it, por deri më tani, fatkeqësisht, ajo nuk ka reflektuar.

Ndërsa Halim Hyseni nga Qendra për Avancimin e Performancës së Sistemit të Arsimit thotë për "Radion Evropa e Lirë" se një grevë si kjo e arsimit, pa një kohë të caktuar, mund të vërë në pikëpyetje përfundimin legal të vitit shkollor akademik 2018-2019. Sipas tij, nëse kjo grevë zgjatet, atëherë bllokohet i tërë sistemi i edukimit dhe arsimit në Kosovë. Ai shton se pasojat e deritashme në arsim janë të pariparueshme. Greva e punonjësve të arsimit në Kosovë ka filluar më 14 janar, kur pritej të niste gjysmëvjetori i dytë në institucionet parauniversitare, pas pushimit dimëror. Projektligji për pagat pritet që të procedohet në Kuvendin e Kosovës më 31 janar së bashku me Projektligjin për buxhetin 2019.

cilat, sipas statistikave kriminalistike, shfaqen të shtuara në vjeshtë dhe dimër.

"Epoka e re": *Si duhet t'u përgjigjen institucionet e sigurisë, përkatësisht policia, këtyre ngjarjeve?*

Selimi: Me vigjilencë të shtuar, bashkëpunim me agjencitë private të sigurisë dhe duke këmbëngulur në zbatimin e strategjisë së policisë në bashkësi bashkë me strategjinë e policisë nëpërmjet inteligjencës. Besoj fuqishëm se lidhshipi aktual i policisë është duke vazhduar, mbase edhe më mirë se paraardhësit, duke më përfshirë edhe mua, që suksesin e parandalimit të krimeve ta arrijë nëpërmjet zbatimit fanatik të këtyre strategjive.

"Epoka e re": *Në përplasjet e policisë me grabitësit kemi pasur edhe viktimë nga të dyja palët. A*

do të thotë kjo se grabitësit nuk po u frikësohen organeve të rendit?

Selimi: Jo, jo. Nuk ka të bëjë me frikë. Policia e Kosovës është forcë autoritative, në kuptimin e vlerave dhe meritave që i ka, së cilës ia kanë frikën edhe kriminelë rajonalë e ndërkombëtarë. Disa prej tyre, tani prapa grilave, veç e kanë provuar. Fatkeqësisht, profesioni i ka edhe sakrificat e veta dhe, së këndejmi, patëm edhe këmbënguljen e Izetit deri në vetëflim për ta përmbushur betimin e profesionit.

"Epoka e re": *Këto ngjarje kanë nxitur debatin rreth mungesës së sigurimit shëndetësor për Policinë e Kosovës. A do të ndikonte siguri shëndetësor për performancë më të mirë të policisë po që se do të kishin pjesëtarët e saj?*

Selimi: Debatimi për siguri shëndetësor është debat gati dy



Ministri Tahiri: Kodi Civil, produkti më i madh legjislativ pas Kushtetutës

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 JANAR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, së bashku me shefen e Zyrës së BE-së, përfaqësuesen e posaçme të BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, kanë hapur të enjten tryezën "Rruga drejt një Kodi Civil modern të Kosovës" organizuar nga projekti i financiar nga Bashkimi Evropian "Mbështetje Kodit Civil - faza 2". Ministri Tahiri ka theksuar se, krahas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, Kodi Civil ka qenë, po ashtu, prioritet themelor meqenëse është një prej produkteve legjislative më të mëdha pas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. "Në një rend liberal dhe demokratik, siç po punojmë çdo ditë e më shumë për ta fuqizuar në Republikën e Kosovës, ekonomia e lirë e tregut dhe marrëdhëniet kontraktuale janë pjesa më fundamentale e këtij rendi. Garantues i tyre është sundimi i ligjit dhe siguria juridike, e cila nuk bën të kërcënohet nga zhvillimet dhe ndryshimet e

shpeshta të ligjeve, shpeshherë pa iu dhënë mundësia të vihen në zbatim në praktikë. Mbi këtë bazë, pra mbi nevojën që të garantojmë siguri juridike për çështjet që janë fundamentale për një rend liberal, ka qenë jashtëzakonisht e nevojshme një kodifikim i së drejtës civile" ka theksuar ministri Tahiri. Ministri Tahiri ka shprehur bindjen se Kodi Civil do të ofrojë dispozita të përshtatshme për krijimin e një ambienti ekonomik ku kontrata ka fjalën e fundit në zbatim. "Ky Kod ka mundësuar zgjidhje të reja dhe më të përshtatshme të bazuara në premisat themelore të rendit liberal, siç janë liria, pacenueshmëria e lirisë individuale të zgjedhjes, barazia para ligjit, liria kontraktuale dhe, mbi të gjitha, pacenueshmëria e pronës. Një gjë e tillë do t'u ndihmojë qytetarëve të Republikës së Kosovës të përfitojnë nga të drejtat e tyre. Gjyqtarët do ta kenë më të lehtë që t'i interpretojnë dispozitat si dhe këto norma të kodifikuara, do të ofrojnë dispozita të përshtatshme për krijimin e një



ambieni ekonomik, ku kontrata ka fjalën e fundit në zbatim" ka theksuar ministri Tahiri. Pas një pune dyvjeçare të ekspertëve, Draft Kodi Civil është i gatshëm të dalë në konsultime publike para se të miratohet në mbledhjen e Qeverisë dhe të dërgohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Shefja e Zyrës së BE-së, përfaqësuesja e posaçme e BE-së

në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka theksuar se përfundimi i draftimit të Kodit Civil dhe publikimi për konsultime me publikun është arritje e madhe për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me vlerat evropiane. Kodi Civil ka pesë pjesë: Pjesa e Përgjithshme, Libri për të Drejtën Familjare, Libri për të Obligimet, Libri për të Drejtat Pronësore dhe Libri për

Trashëgiminë. Këta libra përputhen me standardet e aplikueshme të Bashkimit Evropian dhe do ta mbështesin bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile - lokale dhe ndërkombëtare - me të gjithë partnerët përkatës, si gjyqësori, avokatët, noterët, odat ekonomike dhe të gjithë partnerët e tjerë relevantë profesionalë.

Limaj takon kryetarin e Lëvizjes Besa, flasin për zhvillimet në Maqedoninë Veriore



PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur të enjten në një takim kryetarin e Lëvizjes Besa në Maqedoninë Veriore, Bilall Kasami, i shoqëruar me bashkëpunëtorë. Limaj e ka uruar Kasamin për miratimin e ndryshimeve kushtetuese të cilat mundësuan ndryshimin e emrit të shtetit. Ai ka vlerësuar lart kontributin e Lëvizjes Besa dhe të partive shqiptare për miratimin e ndryshimeve kushtetuese. Limaj ka thënë se

deputetët e Kuvendit të Maqedonisë Veriore me votën e tyre pro marrëveshjes se Prespës për ndryshimin e emrit, zgjedhën rrugën e integriteteve evropiane. "Është bërë një hap i madh me miratimin e këtyre ndryshimeve. Vlerësoj se kjo i kontribuon paqes dhe stabilitetit në rajon", ka thënë Limaj. Ai ka porositur Kasamin të bashkëpunojë me partitë shqiptare në mënyrë që të jenë faktor i rëndësishëm në Maqedoninë Veriore. Ndërsa kryetari i Lëvizjes Besa,

Bilall Kasami, ka thënë se Maqedonia Veriore e ka mbyllur një çështje shumë të rëndësishme. Ai ka thënë se Lëvizja Besa do të vazhdojë të angazhohet për përmirësim të pozitës së shqiptarëve në Maqedoni. Duke folur për zhvillimet në Kosovë dhe dialogun me Serbinë, Limaj tha se dalëngadalë situata po kthehet në normalitet. Limaj ka thënë se Kosova po demonstroi se është e gatshme për bisedime të cilat duhet të përfundojnë me njohje reciproke.

Ish-presidenti Sejdiu viziton Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ka pritur të enjten në takim ish-presidentin e Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu. Në takim ishin të pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjnant Rahman Rama dhe shefi i kabinetit të ministrit, Jashar Ramadani. Ministri Berisha e falënderoi ish-presidentin Sejdiu për vizitën dhe për kontributin e tij në rrugëtimin e shtetit të Kosovës, e në veçanti të FSK-së, më pas e njoftoi me zhvillimet e përgjithshme në

Ministrinë e Mbrojtjes dhe të FSK-së, si për tranzicionin e FSK-së në ushtri dhe zyrtarizimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Ndërsa ish-presidenti Sejdiu, pasi falënderoi ministrin Berisha për pritjen, uroi ministrin dhe komandantin e FSK-së, gjeneral Ramën, për zyrtarizimin e ushtrisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, duke u dëshiruar zhvillim të shpejtë për ngritjen e kapaciteteve ushtarake. Ish-presidenti Sejdiu më pas ka vazhduar vizitën edhe në Kazermën "Adem Jashari" të Forcës së Sigurisë të Kosovës.



Mustafa: Taksa u vendos për t'i mbuluar dështimet e Qeverisë

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se partia e tij është e angazhuar për miqësi të përhershme me ShBA-në dhe partneritet me BE-në. Ai ka shtuar se përgjegjësinë për vendimet që prekin këto marrëdhënie duhet ta marrë Qeveria, por edhe koalicioni qeverisës. Këtë deklaratë Mustafa e ka dhënë duke folur për taksën ndaj Serbisë, për të cilën ka thënë se është masë populiste dhe e pamatur mirë kur është marrë vendimi

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se vendosja e taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës është një masë e merituar por, sipas tij, është masë populiste, e pamatur mirë kur është marrë vendimi. "Nuk ka nevojë të shfrytëzohet taksa për të bërë dallime të brendshme. Si kryetar i LDK-së kam theksuar se është një masë e merituar ndaj Serbisë, po ashtu se është masë populiste, e pamatur mirë në çastin që është marrë", ka thënë Mustafa të enjten në një postim në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se LDK-ja është angazhuar dhe angazhohet për miqësi të përhershme me ShBA-në dhe partneritet me

BE-në. "E vetmja rrugë e Kosovës për LDK-në është rruga euroatlantike. Në këtë frymë është sjellë LDK-ja derisa ka drejtuar Qeverinë, por edhe në kohën kur presidentët e vendit ishin nga LDK-ja. Tani përgjegjësinë për vendimet që prekin në këto marrëdhënie duhet ta marrë Qeveria, por edhe koalicioni qeverisës. Është rregull që ata që marrin vendime, vulosin edhe fatin e vendimeve të tyre", është shprehur Mustafa.

Lideri i LDK-së ka thënë se dihet se taksa u vu një ditë pasi Qeveria dështoi ta anëtarësojë Kosovën në Interpol. "Dështimi iu vesh Serbisë me të drejtë, por për këtë dështim nuk u fajësua askush në Kosovë që nuk e bëri punën mirë. Që ta mund Serbinë. Taksa mbuloi çdo gjë, i mbuloi të gjitha dështimet dhe po vazhdon t'i mbulojë edhe më tutje", ka thënë ai. Mustafa



ka theksuar se LDK-ja nuk e ka propozuar taksën. "Nuk ka ngarendë të marrë merita dhe LDK-ja nuk konsideron se i takon asaj të shprehet se çfarë duhet të bëjë Qeveria me taksën. Kryeministri i ka 35 këshilltarë e 80 zëvendësministra. Sikurse kryetari i Kuvendit dhe zëvendëskryeministri (që u ofruan të marrin merita) le të konsultohen me njerëzit e vet. Ata janë aty për ta dhënë ndihmesën e tyre në punët e

shtetit, jo që me para të shtetit ta sulmojnë opozitën", ka deklaruar Mustafa. Ai ka thënë se Serbia po vazhdon aktivitetin e ndyrë për tërheqje të njohjeve, por me të nuk po merren ndërkombehtarët. "Të gjithë po merren me taksën e Kosovës. Taksa është bërë kusht nga Serbia për vazhdimin e dialogut, pra një lloj laure. Ne nuk i kemi vënë laura Serbisë. Se çfarë duhet të bëjë apo të mos bëjë për të

vazhduar dialogu. Në momentin që ngrihet laura e taksës, askush nuk e di se ku e çon dialogu Kosovën. Askush nuk ka marrë siguri se Serbia do ta njohë Kosovën, askush nuk ka marrë garanci se nuk do të cenohet shtetësia e Kosovës. E vetmja gjë që vërehet është se dikujt po i ngutet?! Dhe e vetmja gjë që dihet është se punët e shtetit nuk bëhen me nguti", ka thënë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa.

Mbingarkohet Klinika Emergjente, 260 raste për 24 orë

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 JANAR - Klinika Emergjente e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka qenë e mbingarkuar në 24 orët e fundit. Sipas statistikave të kësaj klinike, 260 pacientë kanë kërkuar ndihmë mjekësore. 56 raste kanë marrë shërbime mjekësore në dhomën e reanimimit (dhoma e kujdesit të avancuar emergjent), 58 raste kanë qenë të natyrës kirurgjike, 85 raste morën shërbime në dhomën internistike, u ofruan 45 shërbime oropedike, përdërisa kishte 15 raste që kërkuan ndihmë mjekësore si pasojë e aksidenteve në trafik.

67 raste emergjente në Pediari

Ndërkaq Emergjencia Pediatrike e Klinikës së Pediatrisë në 24 orët e fundit ka pasur gjithsej 67 raste të fëmijëve që kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Po ashtu, 67 raste ka pasur edhe në ambulancat spe-

cialistike të profileve të ndryshme të kësaj klinike. Nga vizita e përgjithshme, ka pasur 21 pranime të fëmijëve për trajtim të mëtejshëm në kuadër të Klinikës së Pediatrisë.

Gjinekologji, 36 lindje për 24 orë

Në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike ka pasur 36 lindje për 24 orë. Prej tyre, 23 lindje me operacion. Nga foshnjat e porsalindura, 15 janë të gjinisë mashkullore dhe 22 femra. Ka pasur një lindje me binjak.

Klinika e Biokimisë, 6 385 analiza laboratorike për 24 orë

Ndërsa Klinika e Biokimisë Mjekësore e QKUK-së në 24 orët e fundit ka realizuar 6 385 parametra laboratorike për 1 439 pacientë. Këto analiza laboratorike janë kryer edhe në 12 laboratorë të klinikave të ndryshme.



Ujësjetësi do t'i shkyçë nga sistemi borxhlinjtë

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 JANAR - Kompania Rajonale e Ujësjetësisë "Prishtina" ka njoftuar të gjithë konsumatorët në zonën e shërbimit, se nga data 1 shkurt do të rifillohet masa ndëshkuese për të gjithë borxhlinjtë e shërbimeve të ujësjetësisë dhe kanalizimit. "Me shkyçje do të përballet sërish secili konsumator që ka dy e më shumë fatura të papaguara ndaj shërbimeve të ujësjetësisë dhe kanalizimit. Në të njëjtën kohë do të vazhdohet procesimi i lëndëve të konsumatorëve

borxhlinj të përbaruesit privatë", është thënë në njoftimin e KRU "Prishtina".

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 1 270 shkyçje individuale nga sistemi i rrjetit të ujësjetësisë për shkak të mospagesave, prej të cilëve janë rikyçur 782 konsumatorë pas realizimit të pagesave të tyre ndaj shërbimeve. Përgjatë inspektimeve në terren, në vitin 2018 janë identifikuar 88 konsumatorë që janë kyçur ilegalisht dhe që të gjithë janë shkyçur nga të gjitha shërbimet. Në shkyçje do të përfshihen tetë komunat në të cilat operon KRU "Prishtina": Prishtina, Fushë-



Kosova, Obiliqi, Podujeva, Shtimja, Drenasi, Lipjani dhe Graçanica. Fokus i ekipeve të shkyçjes do

të jenë qytetet dhe fshatrat. Mbi 50 ekipe të shkyçjes dhe inspektorë do të jenë të shpërndarë në secilën zonë të

shërbimit. Aksioni do të vazhdojë deri në fund të vitit 2019. Paralelisht me shkyçjet, duke filluar nga data 1 shkurt, të gjithë konsumatorët që kanë përfituar nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike në periudhën e caktuar në vitin 2018 dhe nuk u janë përmbajtur kontratës për pagesën me këste të borxhit të riprogramuar, do t'u rikthehet borxhi i falur, bazuar në Ligjin për Faljen e Borxheve Publike, njëkohësisht lëndët e tyre do të procesohen të përbaruesit privatë dhe shkyçja nga shërbimet e ujësjetësisë dhe kanalizimit do të jetë e pashmangshme.



Edhe KOSTT-i me Vala

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Telekom i Kosovës dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) kanë nënshkruar të enjten marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile Vala. Kjo marrëveshje ofron shërbime specifike për nevoja të KOSTT-it, duke e bërë Telekomin e Kosovës partner të besueshëm të këtij institucioni shumë të

rëndësishëm të vendit tonë. "Telekomi i Kosovës ka kënaqësinë të bashkëpunojë me KOSTT-in, duke i ofruar shërbime të telefonisë mobile, fikse dhe të internetit, të cilat, përveçse do t'i mundësojnë personelit të kësaj ndërmarrje publike që të ketë komunikim të pandërprerë, njëherësh do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rrit-

jen e të hyrave të Telekomit të Kosovës, që është synim i menaxhmentit aktual", ka bërë me dije ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi. Shërbimet dhe rrjeti teknik i Telekomit të Kosovës do të mundësojnë komunikim efektiv dhe bashkëpunim fleksibil ndërmjet punonjësve dhe

departamenteve të ndryshme të KOSTT-it. "Arritja e kësaj marrëveshje është një hap i rëndësishëm i bashkëpunimit në mes të KOSTT-it dhe Telekomit të Kosovës pasi kjo do t'i mundësojë personelit të ndërmarrjes sonë që të komunikojë në mënyrë efektive mes vete dhe të bashkëpunojë më lehtë kudo që ndodhet", ka thënë kryeshefi

ekzekutiv i KOSTT-it, Ilir Shala. Kjo marrëveshje bëhet në kuadër të përkushtimit dhe angazhimit të Telekomit të Kosovës që t'i zhvillojë shërbimet telekomunikuese dhe ta shtojë numrin e konsumatorëve, e paraprirë nga marrëveshjet e mëhershme që janë arritur me shumë institucione shtetërore dhe biznese private.

Reçica dhe Roccasalvo diskutojnë për projekte mes MPMS-së dhe UNDP-së

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të enjten në takim ushtruesen e detyrës përfaqësuese e përhershme e

UNDP-së në Kosovë, Alessandra Roccasalvo. Reçica dhe Roccasalvo kanë biseduar rreth planit të punës dhe prioriteteve të MPMS-së për vitin 2019.

Gjithashtu, në takim është diskutuar rreth projekteve të përbashkëta të MPMS-së dhe UNDP-së për këtë vit. Ministri Reçica ka thënë se projektet në masat aktive të tregut

të punës mes UNDP-së dhe MPMS-së kanë treguar rezultate të prekshme për çfarë ka shprehur falënderimet për përkrahje të vazhdueshme.



'SOWI Kosova' do të investojë 155 milionë euro në energji të ripërtërishme

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e kompanisë "SOWI Kosova", Christian Hammeke, dhe Ilir Grapci, nga të cilët është informuar për fazën e

fundit përgatitore, para nisjes së një investimi gjermano-izraelit në fushën e energjisë, i cili kap vlerën prej 155 milionë eurosh. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian

Heldt, dhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala. "SOWI Kosova" është një nga kompanitë e para që do të investojë në energjinë e ripërtërishme me erë si rezultat që buron nga Ligji për Investime Strategjike. Në takim

me përfaqësuesit e kësaj kompanie, Christian Hammeke dhe Ilir Grapci, u informova për fazën e fundit përgatitore, para nisjes së këtij investimi gjermano-izraelit në partneritet me kompaninë kosovare, i cili kap vlerën prej 155

milione eurosh, me kapacitet prodhues prej 105 MW. Edhe një lajm i mirë në vitin e ekonomisë. Tashmë investimet e huaja dhe rritja e punësimeve po shndërrohen në normë në Kosovë", ka thënë Haradinaj pas takimit.



KDI-ja, Kuvendit: Të respektohen procedurat ligjore për trajtimin e Projektligjit për buxhetin

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 JANAR - Kuvendi i Kosovës është duke neglizhuar shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin për vitin 2019, një prej projektligjeve më me rëndësi. Dy muaj është afati i rregullt kohor që Kuvendi e ka në dispozicion që t'i japë miratimin final këtij projektligji që nga data kur është sjellë në Kuvend nga Qeveria.

Qeveria e ka proceduar në Kuvend Projektligjin për buxhetin më 31 tetor të vitit 2018, mirëpo Projektligji ka arritur të miratohet në fund në Kuvend më 21 dhjetor 2018. "Meqë Kuvendi nuk ka arritur që ta miratojë në lexim të dytë Projektligjin për buxhetin deri në fund të muajit dhjetor ashtu siç parashihet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, shqyrtimi i tij është shtyrë për muajin janar të vitit 2019. Në këtë rast, Kuvendi ka qenë i obliguar, në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, gjegjësisht neni 24.2, të marrë vendim për zgjatjen e Ligjit për Buxhetin të vitit paraprak për muajin janar të vitit 2019. Ndërsa në rast se Kuvendi nuk do të arrinte që ta miratonte në lexim të



dytë Projektligjin për buxhetin për vitin 2019 në muajin janar, atëherë Kuvendi do të duhej që të marrë sërish vendim për zgjatje të ligjit paraprak edhe për muajin shkurt", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Sipas KDI-së, mungesa e një vendimi të tillë nga ana e Kuvendit e bën të kundërligjshme çdo

pagesë dhe shpenzim nga çdo organizatë buxhetore gjatë muajit janar bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike (neni 24.3). "Kjo nënkupton që asnjë shërbyes civil ose kompani kontraktuese nga cilado organizatë buxhetore nuk mund të paguhet dhe as të kryhet asnjë shpenzim nga organizatat buxhetore

përderisa nuk ka një vendim nga Kuvendi që autorizon zgjatjen e Ligjit për Ndarjet Buxhetore të vitit paraprak për muajin janar. Është me rëndësi të theksohet fakti që në rast të zgjatjes së Ligjit për Ndarjet Buxhetore të vitit paraprak për tre muajt e parë të vitit aktual, buxheti që mund të shpenzohet për këta muaj është 1/12 pjesë e buxhetit të

vitit të kaluar që është shpenzuar në të njëjtën periudhë kohore", është theksuar në komunikatën e KDI-së.

Përveç kësaj, më 21 janar të këtij viti Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur mbledhje të mbyllur për publikun për shqyrtim të dytë të Projektligjit për buxhetin për vitin 2019, ku edhe do të duhej të votoheshin amendamentet e komisionit funksional si dhe komisioneve të tjera për këtë projektligj. "Në bazë të Rregullores së Punës, neni 65.1, mbledhjet e komisioneve duhet të jenë të hapura, përveç disa rasteve që specifikohen në këtë nen e që asnjë nga ato nuk korrespondon me pikën e diskutuar në këtë mbledhje, atë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për buxhetin", është theksuar në këtë komunikatë. Sipas KDI-së, është tejet e rëndësishme që miratimi i projektbuxhetit të bëhet brenda afateve të përcaktuara me ligjin e lartpërmendur. "Andaj KDI-ja kërkon që të respektohen këto afate dhe që ky projektligj t'i nënshtrohet debatit parlamentar dhe konsultimeve të nevojshme me publikun si dhe të garantohet transparencë e plotë gjatë këtij procesi", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Gjykatës së Gjilanit i shtohen edhe pesë gjyqtarë

GJILAN, 24 JANAR (ER) - Kryetari i Gjykatës Themelore të Gjilanit, Ramiz Azizi, ka pritur në një takim pesë gjyqtarët e rinj, të dekretuar nga presidenti Hashim Thaçi. Me këtë rast, ai u ka uruar fillimin e mbarë të punës në misionin që kanë marrë, njëherësh ka ofruar mbështetjen e atyre si në aspektin teknik, po ashtu edhe në atë profesional. "Ju jeni e ardhmja e sistemit gjyqësor të vendit. Me fillimin e punës tuaj, numri i lëndëve do të vazhdojë të bjerë dhe sukseset nuk do të mungojnë", ka thënë Azizi.

Gjyqtarët e rinj priten që së shpejti ta fillojnë trajnimin njëvjeçar në Akademinë e Drejtësisë dhe, pas përfundimit të trajnimit, do të ngarkohen me lëndë dhe do të gjykojnë. Gjyqtarët e dekretuar janë Arben Xheladini, Kaltrina Haliti, Liridona Haziri, Blerina Jakupi dhe Artan Abazi. Aktualisht kjo gjykatë numëron 42 gjyqtarë.



Linjë e re e autobusëve Prishtinë - ANP 'Adem Jashari'

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, dhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, të enjten kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për jetësimin e linjës së autobusëve Prishtinë - Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" dhe anasjelltas. I pari i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, me rastin e ceremonisë së nën-

shkrimit, ka thënë se kjo marrëveshje shkon në shërbim të qytetarëve dhe pasagjerëve të Aeroportit të Prishtinës. Ai ka shtuar se edhe projekte të tjera do të implementohen në Prishtinë në mënyrë që kryeqyteti ta ndiejë mbështetjen e MIT.

Ndërsa kryetari i kryeqytetit, Shpend Ahmeti, duke e falënderuar ministrin për gatishmërinë e treguar për t'i

dalë në përkrahje Prishtinës, jo vetëm në këtë projekt, por edhe të tjera, ka thënë se ky shërbim që do të realizohet nëpërmjet autobusëve të rinj të "Trafikut Urban", i ka munguar Prishtinës padrejtësisht për kohë të gjatë.

Për këtë projekt do të formohet një komision i përbashkët, i cili do ta caktojë orarin e qarkullimit dhe çmimin për pasagjerët që udhëtojnë në këtë linjë.

QKMF-ja në Mitrovicë përfiton 5 000 euro donacion nga 'Ipko'

MITROVICË, 24 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të kompanisë "Ipko", Arianit Duraku, me të cilin ka biseduar për shtrirjen e rrjetit të kësaj kompanie edhe në fshatrat e Mitrovicës. Pastaj kryetari Bahtiri, i shoqëruar me drejtoreshën e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj Barani dhe përfaqësuesit e kompanisë "Ipko" kanë vazhduar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në



Mitrovicë, ku kompania në fjalë ka dhuruar një donacion me vlerë 5 000 euro për repartin e Pediatriisë.

Me këtë rast kryetari Bahtiri ka falënderuar kompaninë "Ipko" për dhurimin e këtij donacioni dhe bashkëpunimin e mirëfilltë që e kanë ndër vite, duke e vlerësuar donacionin shumë të dobishëm dhe të mirëseardhur sepse është në të mirë të fëmijëve që do të mjekohen në repart. Edhe drejtoresha e Shëndetësisë, Erseka Hasanaj-Barani, e falënderoi kompan-

inë "Ipko" për këtë donacion duke vlerësuar lart rëndësinë e këtyre pajisjeve të cilat stafit të kësaj qendre do t'i ndihmojnë jashtëzakonisht shumë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore më cilësore.

Ndërsa drejtori i QKMF-së, Fevzi Sylejmani, ka thënë se ndihma nga kjo kompani ka qenë e mirëseardhur për pediatriinë. Në anën tjetër, drejtori ekzekutiv i kompanisë "Ipko", Arianit Duraku, ka thënë se një donacion i tillë është realizuar në 20 komuna të Kosovës.

Spitali i Ferizajt pajiset me 20 shtretër të rinj

FERIZAJ, 24 JANAR (ER) - Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) kanë ndarë 20 shtretër të lëvizshëm, me katër thyerje, për spitalin e Ferizajt.

Time Azotiq nga Hani i Elezit, e cila trajtohet në Spitalin e Ferizajt, duke bërë krahasim me shtratit e vjetër, ka thënë se i riu është shumë më i përshtatshëm. Reparti i Dializës në Spitalin e

Ferizajt ka 25 shtretër dhe ofron shërbime 24 orë. Aktualisht në këtë spital trajtohen 81 pacientë, ndërsa gjatë verës numri rritet, pasi aty marrin tretman edhe raste nga diaspora.

Drejtori i Spitalit të Ferizajt, Jeton Zeqiri, ka thënë se ndryshimet e fundit i japin një pamje tjetër pavijonit dhe ngritin cilësinë e shërbimeve për pacientët. Sipas tij, furnizimi me shtretër të rinj ka qenë i domosdoshëm. "Shtretërit

të cilët kanë qenë më herët në spitalin e Ferizajt kanë qenë të amortizuar dhe jofunksionalë. Kemi gjetur mirëkuptimin dhe qysh në momentin e parë kemi pranuar 20 shtretër dhe tash ecuria e punës është shumë më relaksuese", ka thënë Zeqiri. Përveç qytetarëve të Ferizajt, në këtë repart trajtohen edhe pacientë nga Komuna e Kaçanikut, Hanit të Elezit dhe Shtërpçës.



Revolucioni asimetric i kohës sonë



Prof. Lisen
BASHKURTI

Rrjetet sociale po ndryshojnë idetë, dëshirat dhe nevojat e njerëzve. Ato kanë sjellë gjithë njerëzimin në duart tona. Ato e kanë bërë botën sa një portokall. Ato po shndërrojnë doktrinën e globalizmit në një realitet të pakthyeshme. Sasia e informacionit është e pakrahueshme më pak vite më parë. Larmia e informacionit është e pafund. Dinamika e informacionit është marramendëse. Jemi përballë një revolucioni të vërtetë, por përballë një revolucioni asimetric. Asimetria e revolucionit të rrjeteve sociale, tendencën e tij, kahet e lëvizjes dhe të zhvillimit, impaktet kontraktore nuk diktohen gjithaq nga informacioni që vjen nga këto rrjete, por më së shumti nga niveli obserbues, analitik, seleksionues dhe interpretues i individit, grupeve sociale dhe mbarë shoqërisë.

Shoqëria shqiptare vjen pas një periudhe të gjatë indoktrinimi të centralizuar nga lartë-poshtë, nga një kulturë relativisht e ulët dhe nga një vetizolim i plotë. Përballja e shoqërisë shqiptare me revolucionin informativ të rrjeteve sociale po sjellë një tronditje të thellë ideologjike, politike, ekonomike, sociale, kulturore, morale e shpirtërore. Të tëra së bashku kanë prodhuar një furtunë të vërtetë, fundin dhe pasojat e së cilës askush nuk i parashikon.

Rrjetet sociale janë kanale me shumë burime dhe rrugë më shumë kalime. Janë dominuese dhe të pacensurueshme. E vërteta dhe gënjeshtria, autentikja dhe plagjiatura, inspiruesja dhe provokativja, e arsyeshmja dhe lajthitja, e dobishmja dhe rrënuesja, e drejta dhe e padrejta, njerëzorja dhe kriminalja, bamirësia dhe abuzimi, mirënjohja dhe mosmirënjohja kryqëzohen pambarimisht, duke krijuar piramida informacioni kaotik në mendjet e individit dhe të mbarë shoqërisë. Ka më shumë dilema se kurrë. Ka më shumë kaos se asnjëherë.

Duket sikur rrjetet sociale po prodhojnë djallin. Në të vërtetë ato vetëm e kanë nxjerrë djallin nga shishja. Pasi edhe engjëlli edhe djalli flenë bashkë tek i gjalli. Duket sikur rrjetet sociale

po krijojnë anarki. Në fakt ato po zbulojnë anarkinë në kokat dhe dëshirat e njeriut dhe njerëzimit. Duket sikur rrjetet sociale po krijojnë shthurje morale. Në fakt vetëm po e veshin lakuriq moralin e shtirur. Duket sikur po rrënojnë të vërtetën. Në fakt e vërteta që kur ka lindur është sfiduar nga gënjeshtria. Duket sikur të gjithë po na shtyjnë drejt "pranverave arabe". Në fakt ne po ecim vetë drejt "stuhive të një rendi të ri botëror".

Në shoqërinë shqiptare po ndodh revolucion. Por jo revolucion klasik. Është revolucion mental e kulturor. Të pasurit e të varfrit, të diturit dhe injorantët, shumicat dhe pakicat, të rinjtë dhe të moshuarit, meshkujt dhe femrat, të pushtetshmit dhe të dobëtit, entuziastët dhe depresivët, të gjithë të barabartë përballë rrjeteve sociale, të gjithë ndjehen të çmuar dhe të diskriminuar njëkohësisht. Njerëzit në shoqërinë shqiptare po marrin informacion më shumë sesa kanë formim. Po u rritet oreksi më shumë sesa kanë dhëmbë. Pra, shkalla e rrezikut është rritur. Parandalimi është i dobët. Reagimi kontraktore.

A mund të mënjanohet ky revolucion informativ. Assesi jo. Ai vetëm mund të sfidohet. Dhe sfida nuk përballet nga jashtë

brenda, por nga brenda jashtë. Globalizmi nuk është rendje mbas gjithësisë, por ardhja e gjithësisë brenda nesh.

Duket sikur e keqja ka kapluar njerëzimin por, në fakt, njerëzimi vetëm po e zbulon atë.

Duket sikur gënjeshtria po varros të vërtetat por, në fakt, të vërtetat po mësohen më shumë se kurrë. Duket sikur të fuqishmit po shtypin të dobëtit, por në të vërtetë të dobëtit janë më të fuqishëm se asnjëherë dhe të fuqishmit janë më të dobët se kurrë. Fuqia dhe dobësia tanimë varen nga fjala e shprehja e saj.

Rrjetet sociale po lënë pas mjetet e tjera të komunikimit. Legjitimiteti i çdo gjeje është në provë të përhershme. Transparenca po tejkalon çdo cak limitues. Përgjegjshmëria po shndërrohet në tipar individual. Participimi i çdo njeri në punët e gjithkujt po ndodh me shumë se kurrë.

Në fund të fundit, revolucioni informativ i rrjeteve sociale po dëshmon se njerëzimi në tërësi dhe shoqëria shqiptare në veçanti paskan vuajtur më shumë për informacion sesa për bukë dhe liri. Prandaj të gjithë ndihen mirë dhe keq. Ndihen të vlerësuar dhe të fyer. Të mbrojtur dhe të kërcënuar. Por të gjithë ndihen më të gjallë se kurrë. Të gjithë ndihen se janë pjesë e kësaj bote. Njerëzit

shndërrohen në foto me selfie. Selfiet bëhen njerëz me fjalë. Ëndrrat bëhen realitete dhe realitetet ëndrra. Virtualiteti bëhet mënyrë jetese. Jetesa përjetohet përmes virtualitetit. Të gjithë jetojmë në dy gjendje: në realitetin vulgar dhe në atë virtual. Atë që nuk e realizojmë në realitet e realizojmë në virtualitet. Realja dhe virtualja ndërveprojnë brenda nesh deri në pa kufij midis tyre.

Ky është revolucioni asimetric i informacionit të rrjeteve sociale. Njerëzimi ka gjetur atë që ka kërkuar. Njerëzimi ka kërkuar atë që ka gjetur. Pra, njerëzimi është kthyer tek vetvetja. Asimetria e revolucionit të informacionit të rrjeteve sociale ka rrezuar muret brenda njeriut dhe njerëzimit.

Sot njerëzit flasin më pak, por komunikojnë më shumë. Njerëzit janë të heshtur, por më shumë aktivë. Njerëzit janë të mbyllur në vetvete, por më të hapur para botës. Fatin e këtij revolucioni do ta përcaktojë beteja midis të vërtetës dhe të pavërtetës. Në thelb është revolucioni më i madh kulturor në historinë e njerëzimit. E ardhmja iu përket shoqërive të kulturuar. Prandaj shoqëria shqiptare më shumë se për çdo gjë tjetër ka nevojë për kulturë. Përndryshe, na pret kaos i paparashikueshëm dhe tjetërsim i pashmangshëm.

Ushtarët e FSK-së dhe zyrtarët e Ministrisë së Mbrojtjes dhurojnë gjak

PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Aksioni për dhurimin vullnetar të gjakut, me moton "Dhuro gjak, shpëto jetë", për nevojat e Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK), është aktiviteti i parë humanitar pas zyrtarizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë. Pas Ministrisë së Mbrojtjes, aktiviteti po zhvillohet edhe në Kazermën e Forcave Tokësore (KFT) "Adem Jashari në Prishtinë". Me këtë rast, drejtori i Departamentit të Mjekësisë në Ministrinë e Mbrojtjes, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, duke parë nga afër

mbarëvajtjen e aktivitetit, ka përgëzuar ushtarakët dhe shërbuesit civilë të FSK-së për gatishmërinë dhe motivimin e tyre për të dhuruar gjak, në të mirë të shëndetit të pacientëve të institucioneve shëndetësore të vendit tonë.

Vetëm të mërkurën në Ministrinë e Mbrojtjes aksionit i janë përgjigjur mbi 50 dhurues vullnetarë, ndërsa të enjten mbi 70 dhurues nga KFT-ja dhe njësitë pranshtabore të saj. Aksioni humanitar për dhurimin e gjakut në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në të gjitha kazermat e Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) do të



vazhdojë deri më 4 shkurt. Ky është aksioni i parë humanitar për dhurimin e gjakut për këtë vit dhe, sipas planifikimit,

aksioni i dytë pritet të zhvillohet në muajt korrik dhe gusht. Ushtarakët e FSK-së, përveç në aksione të tilla, çdoherë kanë

shprehur gatishmërinë që t'u përgjigjen kërkesave për dhurim të gjakut edhe në periudha të tjera të vitit.

E rrallë

Ngrihet ujëvara e Niagarës

Në Kanada është aq ftohtë saqë një pjesë e ujëvarës së Niagarës ka ngrirë. Temperaturat nën zero kanë krijuar një imazh unik dhe madhështor për sytë e vizitorëve të ujëvarës së famshme. Spiralet e akullit dhe shtigjet e dëborës t'i kujtojnë peizazhet e filmave të animuar të Disneyt, ndërsa ata që e kanë parë nga afër nuk e kanë humbur shansin ta shkrepin foton e jetës së tyre.



FOTO E DITES



Hëna e plotë ngrihet pas maleve të mbuluara me borë në provincën Hakari të Turqisë. Fotografia është realizuar nga Anadolu Agency.

E jashtëzakonshme

Prodhoet trageti i pasagjerëve me hidrogjen

Në fund të vitit 2019 pritet të përfundohet trageti i parë me hidrogjen në San Francisko. Trageti do t'u shërbejë turistëve por, për dalim nga mjetet e tjera lundruese, nuk do ta ndotë ambientin. Water Go Round do të shërbejë për transportin e turistëve në Gjirin



e San Franciskos. Projekti u bë i mundur nga partneriteti i Golden Gate Zero Emission Marine dhe California Air Resources Board. Sipas parashikimeve, trageti do të përfundojë në fund të këtij viti.

BARSOLETA E DITËS



**Djali: Babi, cili është dallimi ndërmjet fjalëve "pa para" dhe "badihava"?
Babai: Është e thjeshtë. Për shembull, ti e ke kryer shkollën e mesme pa para, por ke shkuar atje badihava.**



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Edhe pse jeni fiksuar pas një argumenti të caktuar sot, dikush do t'ju heqë mendjen me të dhënat që do t'ju japë për një temë komplet tjetër.



DEMI

Mes miqve tuaj dhe partnerit ka shumë dallime idesh. Do të jeni i pranishëm në një debat që nuk do të keni mundësi ta shmangni.



BINJAKËT

Shumë ditë e qetë sot. Përveç punës, nuk keni asgjë tjetër interesante që mund t'ju zë ditën. Nuk do të jeni në humor gjatë paradites.



GAFORRJA

Duhet të tregoheni më elastike me persona të cilët në një mënyrë apo në një tjetër ndikojnë në të ardhmen tuaj. Ndonjëherë bëni mirë të heshtni.



LUANI

Gjithçka që po bëni për momentin ju intrigon dhe ju jep shumë kënaqësi. Si në karrierë dhe si në çështjet personale, gjërat po shkojnë më mirë nga sa prisnit.



VIRGJËRËSHA

Dukeni të përhumbur sot, por do të dalë një person që do t'ju tregojë rrugën e duhur. Keni filluar ta kuptoni rëndësinë e gjërave të vogla.



PESHORJA

Planetët nuk i keni në anën tuaj sot dhe duhet ta zgjidhni vetë çdo problem që mund të hasni. Ndihehi si të zënë në kurth lidhur me një situatë.



AKREPI

Paraqiten plane për udhëtime të largëta për ju dhe sot është dita kur do të vendosni njëherë e mirë se çfarë do të bëni.



SHIGJETARI

Sot nuk jeni në humor të mirë dhe do të reflektoni mbi vendime që do të peshojnë shumë në të ardhurat tuaja.



BRICJAPI

Shenja nervozizmi që nuk po arrini t'i kontrolloni do të shfaqen gjatë një takimi të rëndësishëm si pasojë e një neglizhence të një personi të afërt.



UJORI

Kjo ditë, përveç reduktimit të dukshëm të financave, do të ketë edhe probleme të tjera dhe në fund të saj do të jeni shumë të tensionuar.



PESHQIT

Mirë që miqtë janë gjithmonë pranë jush për t'ju qartësuar idetë sepse do ta gjeni veten në një rrëmujë të çuditshme mendimesh.

'Flaka e Janarit', aktivitet me të cilin identifikohet Gjilani

GJILAN, 24 JANAR (ER) - Në qytetin e Gjilanit është mbajtur manifestimi i 28 kulturor i Flakës së Janarit, i cili është edhe një ndër aktivitetet me të cilin identifikohet Gjilani. Në kuadër të aktiviteteve ka nisur Festivali i Dramës Kombëtare "Talia e Flakës", i cili ka një karakter garues. Në këtë ngjarje mori pjesë edhe zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Leonora Morina-Bunjaku, e cila i përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi organizatorët për ngjarjen me të cilën Gjilani mori identitet. "Ndihehem e vlerësuar t'ju drejtohem në emër të MKRS-së, që me konsideratë po e mbështet këtë manifestim, me besimin e rritës së tij, me vlerësimin për vlerat kulturo-artistike që përfaqëson e paraqet dhe synon t'i ngrehë", ka thënë zëvendësministria

Morina-Bunjaku.

Duke folur për festivalin, zëvendësministria tha se ai filloi si "manifestim i kujtesës historike mbi të kaluarën tonë të largët e të afërt, si vlerësim mbi Janarin e Skënderbeut, janarin e përflakur të vëllezërve Gërvalla e Kadri Zeka, Rexhep Mala e Nuh Berisha dhe vargun e pafund të përpjekjeve, heroizmave e sakrificave për liri". "Filloi para 28 vjetësh që të jetë muzë e lirisë sonë. Me artin skenik, pamor, letrar e muzikor, katër shtyllat e këtij manifestimi u bë identitet kulturor i Gjilanit, vendtakim vlerash artistike", ka theksuar zëvendësministria Morina-Bunjaku, duke shtuar se për pesë net Teatri i Gjilanit do të jetë Olimpi ku do të vijë dramat e shumta nën interpretimin e shkëlqyeshëm të artistëve nga gjithë hapësirat shqiptare.



Shfaqet premiera e filmit dokumentar 'Koha e pelikulës'



PRISHTINË, 24 JANAR (ER) - Në kuadër të aktiviteteve me rastin e 90-vjetorit të lindjes së regjisores së mirënjohur të kinemasë shqiptare, Xhanfise Keko, nën përkujdesjen e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, Kujtim Gashi dhe ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës, Qemal Minxhozi, është shfaqur premierë filmi dokumentar "Koha e pelikulës" i regjisorit Mevlan Shanaj, dedikuar artistes që ia kushtoi krijimtarinë botës së

madhe të fëmijëve të vegjël.

Dokumentari kushtuar Xhanfise Kekos "Koha e pelikulës" është konceptuar si një rrëfim i autores, mbështetur në librin e saj "Ditët e jetës sime", kujtime dhe libri i shkruar nga aktorët e saj të vegjël "Teta Xhano".

Organizuar në skenar nga Natasha Lako brenda këtij materiali si bazë shërbejnë kujtimet e Xhanos të qemtuara dhe lexuara si monolog. Materialet ilustruese ngarkuar me imazhe, nga arkivi, kronikat, filmat artistikë dhe mjediset kryesore të autores, që

nga qyteti i lindjes Gjirokastra, fshati Dardha i Endri Kekos, bashkëshorti.

Me këtë rast ministri Gashi ka thënë se MKRS-ja dhe Ministria e Kulturës së Shqipërisë çdo vit nënshkruajnë kalendarin e përbashkët kulturor me qëllim të realizimit të aktiviteteve të dakorduara nga të dyja palët. "Unë si ministër i Kulturës jam i përkushtuar që edhe më tej saj të mbështes nisma dhe iniciativa të ndryshme për shënimin e ditëve dhe datave të veçanta të cilat kanë për qëllim afirmimin e mëtejshëm të

kombit tonë e të qytetarëve tanë. Zona e madhe e filmit shqiptar, siç quhet me të drejtë, më 4 janar mbushi 90 vjet. Ne sot po e festojmë së bashku ditëlindjen e saj, pasi e meriton nderimin e Kosovës artistja e madhe që na nderoi e na bëri krenarë të gjithë shqiptarëve", ka thënë ministri Gashi. "Duke rikthyer e kujtuar filmat e realizuar shumë vjet më parë, si: 'Kryengritje në pallat', 'Mimoza llastica', 'Qyteti më i ri në botë', 'Beni ecën vetë', 'Tingujt e luftës', 'Tomka dhe shokët e tij', 'Pas gjurmëve', 'Një vonesë e

vogël' filma ku ajo shkëlqeu me tërë forcën e talentit të saj, konstatojmë se, përpos të tjerave, imazhet e saj ndërtojnë atë forcë shprehëse të botës shqiptare e cila inkuadron për herë të parë në botën e saj interesat e fëmijëve që të çojnë gjithnjë e më tepër drejt lirisë dhe përparimit", ka theksuar ministri Gashi. Ai ka shtuar se koha ka treguar se ajo i ka kapërcyer caqet e një autoreje filmi për fëmijë, pasi tematikat e filmave të saj mbeten aktuale sa iu takon marrëdhëniet të fëmijëve me natyrën, prindërit, shokët, mësuesit, misterin, dhunën, të vërtetën, padrejtësitë.

Më tutje, ministri ka shtuar se "artistja unike e filmit shqiptar i ka lënë trashëgimisë kombëtare një numër kryeveprash filmike nga më të dalluarat e më të rrallat, nga më jetëgjatët dhe më të mirëpriturit për publikun shqiptar dhe i ka sjellë kinematografisë shqiptare vërtetësinë dhe realizmin e thjeshtë të jetës, duke sfiduar çdo element propagandistik të kohës. Regjisorja shqiptare Xhanfise Keko zë një vend të nderuar në altarin e kinematografisë botërore, ku deri në vitet '60 regjisoret, veçanërisht në filmin e gjatë artistik, pothuajse mungonin krejt".

Në fund ministri Gashi ka falënderuar ambasadorin e Ambasadës së shtetit shqiptar, Qemal Minxhozi, i cili, sipas tij, ishe nismëtar i kësaj ngjarje të shënohet në Prishtinë. "Ne do të angazhohemi që ngjarje të tilla të shënojmë edhe më tej duke qenë përherë mirënjohës për kontributin dhe gjurmët e pashlyeshme që na lanë figurat e rëndësishme siç ishte e ndjera zonja Keko", ka thënë ministri Gashi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ARSENAL - MAN UTD

3+

BRISTOL CITY - BOLTON

3+

HERTHA BERLIN - SCHALKE 04

3+

Majlinda, e 'artë' në Izrael

Krenaria e sportit të Kosovës, Majlinda Kelmendi, është paraqitur jashtëzakonisht mirë në Izrael, pasi ka fituar katër luftëra për ta rrëmbyer 'Medaljen e Artë'. "E arta e kombit. Grand Prix Tel Aviv, një finale e çmendur e Majlindës. I lumtur shumë me performancën e saj", ka thënë trajneri Driton Kuka



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 JANAR - Xhudistja më e mirë shqiptare, Majlinda Kelmendi, e ka nisur në mënyrën më të mirën vitin 2019, pasi e ka fituar "Medaljen e Artë" në Grand Prix "Tel Aviv 2019", i cili po mbahet në Izrael. Para fillimit të kësaj gare faqja zyrtare e Federatës Ndërkombëtare të Xhudos (IJF) ka shkruar se ky vit pritet të jetë plot shkëlqim për Majlindën, e cila shkëlqeu në finale ndaj garueses izraelite Gili Cohen, duke e mposhtur me "ippon" për vetëm 35 sekonda. Kelmendi raundin e parë e kaloi pa

luftë, ndërsa në të dytin mposhti me "ippon" Tetiana Levyskan e Gjeorgjisë, kurse në çerekfinale e mposhti po me "ippon" zviceranen Fabienne Kocher. Edhe në gjysmëfinale shënoi fitore me "ippon" ndaj rumunes Andrea Chitun. Pasi rrëmbeu "Medaljen e Artë", Majlinda është vlerësuar si e arta e Kosovës nga trajneri Driton Kuka, i cili është shprehur shumë i kënaqur me paraqitjen e saj në këtë garë shumë të rëndësishme. "E arta e kombit. Grand Prix Tel Aviv, një finale e çmendur e Majlindës. I lumtur shumë me performancën e saj", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Triumfin e Majlindës e ka përshëndetur edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj. "Edhe një triumf tjetër për t'u admiruar i xhudistes sonë, e cila fitoi të 'artën' në Grad Prix të Tel Avivit. Të lumtë, Majlinda!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Majlinda që deri tash ka fituar 26 medalje të arta, 5 medalje të argjenda dhe gjashtë të bronzta me medaljen e fituar të enjten shtoi në llogarinë e saj edhe 700 pikë olimpikë për Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020". Ndërsa sot (e premte) në Tel Aviv garon Loriana Kuka në kategorinë deri në 78 kilogramë.

SHKURT

Sokoli, trajner i Ferizajit

Bylbyl Sokoli do të jetë trajner i ri i skuadrës së Ferizajit. "Profa", i cili edhe në të kaluarën ishte pjesë e kësaj skuadre, do të jetë pasardhës i Afrim Tovërlanit që dha dorëheqje javë më parë. "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se sot kemi arritur marrëveshje me trajnerin e mirënjohur Bylbyl Sokoli. Pas largimit të Afrim Tovërlanit, skuadra jonë menjëherë ka gjetur zëvendësuesin e tij, ku shpresojmë dhe besojmë se do t'i arrijmë objektivat e klubit për këtë sezon. Të gjithë në klub e njohin 'Profën' dhe nuk kemi dyshim se do ta bëjë punën e tij siç është më së miri", thuhet në njoftimin e KF Ferizaj.

Guardiola lavdëron portierin e Kosovës

Skuadra e Manchester Cityt është kualifikuar në finale të Carabao Cup, pasi e ka mposhtur Burton Albionin në gjysmëfinale me rezultat të përgjithshëm 10-0. Portieri i Kombëtares së Kosovës, Arijanet Muriqi, ishte nga fillimi i ndeshjes dhe nuk pranoi gol, po ashtu Muriqi ka pranuar vetëm një gol në pesë ndeshjet e tij të fundit me Cityn. "Ata kishin dy ose tri shanse të mira. Aro Muriqi ishte i mrekullueshëm", ka thënë Guardiola.

Ndërpriten kërkimet për gjetjen e futbollistit Sala

Kërkimet për gjetjen e avionit, ku në bord ishte dhe Emiliano Sala, kanë përfunduar. Autoritetet kanë konfirmuar se pas 72 orësh kërkim, çdo gjë ka marrë fund dhe nuk mund të gjendet asnjë shenjë nga avioni i zhdukur. Sipas asaj që raportohet nga "Daily Maili", kërkimet kanë nisur që të hënën dhe kanë përfunduar të enjten pa asnjë rezultat. Sulmuesi argjentinas Sala që udhëtonte nga Franca për në Cardiff, pasi kishte nënshkruar kontratën e re, ishte në avion dhe nuk ka asnjë shenjë jete deri më tani. Sipas asaj që raportohet, policia e Guernsey ka shteruar çdo lloj mundësie për ta gjetur avionin e zhdukur dhe ka pezulluar çdo kërkim. Me shumë mundësi pas këtij njoftimi nuk do të ketë asnjë kërkim tjetër për sulmuesin argjentinas.

Dënim i rëndë për Romela Begajn

TRANË, 24 JANAR - Kampionja në peshëngritje, Romela Begaj, është dënuar sërish nga Federata Botërore e Peshëngritjes, pasi janë gjetur substanca dopingu në sistemin e saj. Peshëngritësja kuqezi është dënuar dhe më parë për përdorim dopingu dhe, si pasojë, ky dënim i përsëritur është shumë më i rëndë se ai i

pari. Sipas një dokumenti i cili është siguruar nga "TopChannel", Begaj është dënuar plot tetë vjet nga aktivitet sportive. Duke marrë parasysh moshën e sportistes kuqezi (33 vjeçe), karriera e saj mund të konsiderohet e përfunduar. "Duke qenë se sportistja e ka të përsëritur pozitivetin ndaj

dopingut, do të dënohet me sanksionin maksimal që është tetë vjet dhe do të hiqen të gjitha rezultatet nga aktiviteti ku ka rezultat pozitiv dhe të gjitha rezultatet nga periudha e fillimit të kësaj çështjeje, që është fundi i vitit 2017", thuhet në vendimin e Federatës Botërore të Peshëngritjes.



Toronto dështon ndaj Indianas

TORONTO, 24 JANAR - NBA, kampionati më i fortë dhe më emocionues në botë i basketbollit, vijon të dhurojë spektakël e surpriza. Së fundi, janë luajtur dhjetë ndeshje, ku dy favoritët për të qenë në fazën e "play-off"-it janë

mundur në konferencat e tyre. Më konkretisht, Toronto Raptors nuk ia ka dalë të ketë vazhdimësi të fitoreve. Kësaj here është mundur në mënyrë të papritur nga Indiana Pacers me rezultatin 110:106. Houston Rocketsi ka triumfuar

falë paraqitjes së shkëlqyer të James Hardenit, i cili realizoi 61 pikë. Pas këtij "stacioni" të kampionatit, Toronto mban vendin e dytë në Konferencën e Perëndimit, me 36 fitore dhe 14 humbje. Rezultatet: Boston - Cleveland

123-103, Brooklyn - Orlando 114-100, Miami - L. A. Clippers 99-111, Chicago - Atlanta 101-121, Memphis - Charlotte 107-118, New Orleans - Detroit 94-98, Philadelphia - San Antonio 122-120, Utah - Denver 114-108.



Dy derbi në basketboll

PRISHTINË, 24 MARS - Xhiroja e XVI në Superligën e Kosovës në basketboll veçohet me dy ndeshje mjaft interesante që zhvillohen në Gjakovë dhe Mitrovicë. Të shtunën me fillim nga ora 17:00 në Gjakovë, Rahoveci është nikoqir i Bashkimit në palestrën "Shani Nushi", ndeshje kjo në të cilën pritet të mos mungojë rivaliteti. Rahoveci aktualisht është në pozitën e tretë me 15 pikë, me 10 fitore e 5 humbje, kurse Bashkimi është në vendin e pestë me 7 fitore e 8 humbje. Të shtunën në program është edhe dueli në mes të Z Mobile Prishtinës dhe Lipjanit, takim ky që luhet me fillim nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. "Bardhekaltrit" kryesojnë në renditjen tabelore ku nga 15 ndeshje kanë po aq fitore, kurse Lipjani është në pozitën e shtatë me 2 fitore e 13 disfata. Ndërkaq të dielën me fillim nga ora 17:00 do të zhvillohet derbi tjetër i kësaj xhiroje, ai në Mitrovicë në mes të Trepçës dhe Golden Eagle Yllit, ndeshje kjo e cila pritet të sjellë rivalitet të madh në parket. Mitrovicasit aktualisht janë në vendin e katërt me 7 fitore e 8 humbje, kurse ekipi nga Suhareka zë pozitën e dytë me 10 fitore e 5



humbje. Me duelin në mes të Ponte Prizrenit dhe AFK Borea që do të luhet të dielën me fillim nga ora 19:00 në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren përmbyllet xhiroja e XVI në elitën e basket-

bollit të Kosovës. Ponte Prizreni renditet në pozitën e gjashtë në renditjen tabelore me 6 fitore e 9 humbje, kurse AFK Borea është në vendin e fundit me vetëm 3 fitore e 12 humbje.

Nadali shuan ëndrrën e Tsitsipas, Osaka-Kvitova finalja e femrave

MELBOURNE, 24 JANAR - Mrekullia me emrin Stefanos Tsitsipas përfundon në gjysmëfinale. Rafael Nadal është finalist i parë i "Australian Open". Tenisti spanjoll mundi në gjysmëfinale grekun Stefanos Tsitsipas me rezultatin 3-0, me sete 6-2, 6-4 dhe 6-0, ndeshja zgjati një orë e 46 minuta. Tsitsipas konsiderohet si e ardhmja e tenisit, pasi është 20-vjeçar dhe është cilësuar si një tenist mjaft i talentuar dhe që pritet të ngjisë majat në vitet e ardhshme, ndërsa në "Australian Open" nxori jashtë nga turneu zviceranin Roger Federer. Gjithsesi talenti i tij nuk u konsiderua nga Nadali, i cili ia bëri më të thjeshtë vetes kalimin në finale. Kjo është hera e 25-të që spanjollit shkon në një finale Grand Slam, për më tepër që këtë herë u kualifikua pa humbur asnjë set. Finalja do të zhvillohet të dielën, më datë 27 dhe Nadali pret ta mësojë kundërshtarin mes rivalëve



Djoković dhe Pouille që do të ndeshen nesër në 9:30 në gjysmëfinale. Te femrat është përcaktuar çifti finalist. Të shtunën do të përballen mes tyre për trofeun e "Australian Open" numri 4 i botës dhe fituesja e grand slamit të fundit të vitit të kaluar,

japonezja Naomi Osaka dhe tenistja nga Republika Çeke, Petra Kvitova, e cila renditet e 6-ta në botë. Osaka në gjysmëfinale mposhti 2-1 me sete çeken tjetër Karolina Pliskova, ndërkohë që Kvitova mposhti pastër 2-0 me sete amerikanen Collins.

SHKURT

Lëndimi i Neymarit është serioz

PSG-ja fitoi 2-0 ndaj Strasburgut në Kupën e Francës, por në fund askush nuk e kishte mendjen te ndeshja, sepse fokusi ishte te dëmtimi i pësuar nga ylli brazilian Neymar. Sulmuesi u dëmtua në këmbën e djathtë pas një dueli me mbrojtësin Zamzani, i cili i ndërhyri tri herë rresht, para se gjyqtari të fishkëllente për faull. Ndonëse vijoi të luante edhe për disa minuta, Neymar u zëvendësua dhe u pa i përloitur teksa shkonte drejt dhomave të zhveshjes. Ende nuk dihet se a do të mungojë braziliani për ndonjë kohë për shkak të këtij lëndimi.

Higuaini: Kam ëndërruar të luaj për Chelsea

Gonzalo Higuain nënshkroi kontratë gjashtëmujore që do ta lidhë me Chelsea deri në fund të këtij sezoni, ndërkohë u shfaq shumë i lumtur për këtë aventurë. Në bazë të paraqitjeve të lojtarit, Chelsea do të vendosë nëse do ta blejë ose jo përfundimisht "El Pipitan" në fund të kampionatit. "Nuk mund të mos e shfrytëzoja mundësinë për t'iu bashkuar Chelsea. Është një skuadër që më ka pëlqyer gjithmonë dhe që ka një histori të madhe, një stadium të mrekullueshëm dhe luan në Premierë Ligë, një kampionat ku kam dashur gjithmonë të luaj. Tani shpresoj t'ia shpërblej në fushë besimin që klubi tregoi tek unë. Pres me padurim të nis këtë aventurë të re dhe shpresoj të përshtatem sa më shpejt që të jetë e mundur", ka thënë Higuaini.

Dele Alli mungon deri në mars

Pas ekzaminimit mjekësor u përcaktua shkalla e lëndimit të Dele Allit. Futbollisti anglez do t'i mungojë Tottenhamit deri në fillim të muajit mars për shkak të lëndimit të parakohshëm, njoftoi klubi i Londrës. "Pas skanimit dhe ekzaminimit u konstatua një dëmtim në këmbë. Ai do të rehabilitohet me ekipin tonë mjekësor dhe pritet të kthehet në seancat stërvitëse në fillim të muajit mars", njofton skuadra e Tottenhamit.

Skriniari, besnik i Interit

Milan Skriniar paralajmëron rinovimin e kontratës me Interin. Mbrojtësi zikaltër në një intervistë të dhënë është shprehur se shumë shpejt do të vijë dhe zyrtarizimi i marrëveshjes me klubin deri më 2023. "Të gjithë e dinë se unë dua të qëndroj tek Interi. Unë dhe menaxheri im jemi duke biseduar me drejtuesit e klubit dhe mund t'ju them se jemi shumë pranë akordit. Nuk mund të them një datë ose periudhë fikse se kur mund të vijë zyrtarizimi, por do ta gjejmë çastin e duhur", ka thënë Skriniar. "Në fillim kujtova se ishte një shaka nga ana e Spalletit. Sigurisht se u ndjeva mirë, por mendoj se vlera monetare nuk ka rëndësi, por se çfarë unë jap në fushën e blertë. Ka lojtarë që të tilla komente i vënë nën presion. Tek unë nuk ndodh një gjë e tillë. Sidoqoftë, e falënderoj Spalletin për vlerësimin", ka deklaruar Skriniari.

Piateki: Do ta rikthej Milanin në Ligën e Kampionëve

Sulmuesi i ri i Milanit, Krzysztof Piatek, ka thënë se do të bëjë gjithçka për ta kthyer Milanin në Ligën e Kampionëve. Sulmuesi polak iu bashkua skuadrës kuqezi për 35 milionë euro nga Genoa. "Për mua është një tjetër hap përpara në karrierën time. Shpresoj se mund të luaj mirë me Cutronen. Duam të shënojmë shumë gola së bashku dhe shpresoj se gjërat do të shkojnë mirë për ne. Mund të luaj me një sulmues tjetër pranë meje. Është një ëndërr e bërë realitet, pasi pranë meje është Maldini, të cilin unë e kam admiruar gjithmonë. Për mua është nder i madh të jem këtu. Do të bëj gjithçka për ta kthyer Milanin në Ligën e Kampionëve", ka thënë Piatek. "Isha një tifoz i Milanit duke u rritur dhe ishte ëndërra ime për të luajtur këtu. Vetëm të ulem pranë legjendave si Maldini dhe Leonardo është nder i madh. Shpresoj se mund ta tregoj talentin tim në çdo lojë. Nuk mund të them asgjë këtu, por gjithçka do të vendoset në këtë fushë", ka deklaruar Piatek.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data



Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale, shpallë:

Konkurs

Për plotësimin vendit të lirë të punës: Një (1) pozitë.

Titulli i postit: Zyrtar ligjor 2

Marrëdhënia e Punës: Në bazë të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe akteve tjera normative, të cilat rregullojnë punësimin në SHCRK.

Koeficienti: Shtatë (7)

Numri i referencës së vendit të punës: LI/060/JP00037403

I raporton: Udhëheqësit të Departamentit Ligjor

Orari i punës: 40 orë/javë

Vendi: Prishtinë

Qëllimi i punës dhe rezultatet: Hartimi, zhvillimi dhe harmonizimi i legjislacionit dhe akteve tjera ligjore si dhe dhënia e këshillave për menaxhmentin dhe njësitë organizative të Agjencisë, me mbikqyrje të kufizuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Ndihmon mbikqyrësin dhe zyrtarin e lartë ligjor në hartimin e planeve të punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e objektivave të njësisë;
2. Harton dhe zhvillon legjislacionin dhe aktet tjera juridike, kontrata, marrëveshje nga fushëveprimtaria e Agjencisë;
3. Bën hulumtime dhe analiza që ndërlidhen me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë së Agjencisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e Agjencisë;
4. Bën pajtueshmërinë e projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me kornizën kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe merr pjesë në hartimin e strategjisë legjislative të Agjencisë;
5. Kujdeset që përmbajtja dhe forma e projekt akteve normative të jetë e saktë, si nga aspekti gjuhësor e teknik, si dhe të jenë identike në gjuhët zyrtare;
6. Sipas kërkesës dhe udhëzimeve të nivelit më të lartë, jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
7. Bashkëpunon me njësitë tjera brenda Agjencisë për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë univesitare, fakulteti juridik, minimumi 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së Agjencisë;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, amalitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren në zyrën e personelit, kati i II në ndërtesën e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale. Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni zyrën e personelit, cdo ditë pune prej orës 08:00 deri në ora 16:00 në tel. 038-200-62952. Konkursi ngel i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazeta dhe në tabelën e shpalljeve në ASHMDHP, duke filluar nga data 25.01.2019 deri më datën 08.02.2019, që konsiderohet si dita e fundit e mbylljes së konkursit. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën, vërtetim nga gjykata dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës. Kandidatët të cilën përzgjedhen në listë të ngushtë, do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli. Kandidatët e përzgjedhur janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit intervistues.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.

“Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qëndrore dhe lokale, sic specifikohet në nenin 11 par.3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e te Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data



Na osnovu Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosovo i Uredbi br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja u državnoj službi, Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka, objavljuje:

Javni Konkurs

Popunjavanje slobodnog mesta: Jedna (1) pozicija.

Naziv radnog mesta: Pravni službenik 2

Radni odnosi: Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Kosova i drugih normativnih akata koji regulišu zapošljavanje u KPSC.

Koeficijent: Sedam (7)

Broj slobodnog radnog mesta: LI / 060 / JP00037403

Izveštava: Šefu pravnog odeljenja

Radno vreme: 40 sata/nedeljno

Mesto: Priština.

Svrha rada i ishodi: Izraditi, razviti i uskladiti zakone i druge pravne akte, i dati savete za upravljanje i organizacione jedinice Agencije sa ograničenim nadzorom.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

1. Pomaže nadzorniku i višem pravnom službeniku u izradi planova rada za sprovođenje zadataka utvrđenih na osnovu ciljeva jedinice i daje preporuke u vezi sa postizanjem ciljeva jedinice;
2. Izrađuje i razvija zakone i druge pravne akte, ugovore i sporazume iz delokruga Agencije;
3. Sprovodi istraživanja i analize u vezi sa zakonima i podzakonskim aktima u okviru odgovornosti Agencije i daje preporuke, savete i smernice rukovodstvu Agencije;
4. Na osnovu usaglašenosti nacrta zakona i drugih podzakonskih akata sa ustavnim okvirom i važećim zakonodavstvom na Kosovu i zakonodavstvom EU i učestvuje u izradi zakonodavne strategije Agencije;
5. Osigurava se da sadržaj i oblik nacrta normativnih akata bude ispravan, jezički i tehnički, i da isti bude identičan sa službenim jezicima;
6. Na osnovu višeg nivoa, potražnje i smernica, pruža pravna mišljenja i nacrte nacrta rezolucija, nacrta odluka i drugih nacrta akata;
7. Saraduje sa drugim jedinicama u Agenciji u aktivnostima u oblasti zakonodavstva;
8. Obavlja i druge dužnosti u skladu sa zakonima i propisima koje nadzornik može povremeno zahtevati;

Potrebne kvalifikacije i veštine:

- Univerzitetska diploma, pravni fakultet, najmanje 2 godine profesionalnog iskustva;
- Znanje i iskustvo u izradi, uskladjivanju zakonodavstva i drugih pravnih akata;
